



Albania – Kosovo

IPA Cross Border Cooperation Programme



KONKURS

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) e Kosovës, në cilësi të strukturës operative të Republikës së Kosovës për Programin për Bashkëpunim Ndërkufitar (BNK) ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës për periudhën 2014-2020, fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për pozitën në vijim:

Zyrtar i projektit i specializuar në komunikim dhe informim me orar të plotë për Programin BNK IPA Shqipëri-Kosovë me lokacion në Prizren, Kosovë

Kjo pozitë parasheh 570 ditë pune në minimum përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës tri (3) vjeçare

Kualifikimi dhe shkathtësitë

- Diplomë universitare, preferohet diploma e nivelit Master në fushat e lartpërmendura;
- Rrjedhshmëri në të shkruar dhe të folur në gjuhën angleze dhe gjuhët zyrtare të të dyja vendeve;
- Aftësi kompjuterike (Microsoft Office, internet, etj.)

Përvoja e përgjithshme profesionale Së paku 4 vjet përvojë profesionale pas përfundimit të studimeve Bachelor

Përvoja specifike profesionale

Së paku dy (2) vjet përvojë përkatëse profesionale në programet/projektet e asistencës, të financuara nga BE-ja ose donatorë të tjerë;

- Përvojë në menaxhimin dhe kryerjen e detyrave të shumta në fushën e komunikimit dhe informimit, siç janë organizimi i ngjarjeve, menaxhimi i ueb faqeve, publikimi i filmave, shfaqjeve në TV ose radio si dhe përgatitja e lajmeve të shkurtra dhe buletineve informative;
- Njohuri mbi procedurat e prokurimit dhe granteve të përcaktuara në Udhëzuesin Praktik për veprimet e jashtme të BE-së (PRAG).
- Kandidati duhet të ketë nënshtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit

- Curriculum Vitae (CV) e formatit Europass në gjuhën angleze;
- Një letër motivimi në gjuhën angleze;
- Një kopje të diplomës universitare;
- Kopje të certifikatave të trajnimeve të ndjekura;
- Dokumente tjera mbështetëse.

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit në kopje fizike prej **09 Nëntor 2016 deri më 18 Nëntor 2016 deri në ora 16:00h** në adresat në vijim:



This project is funded by the European Union



Albania – Kosovo
IPA Cross Border Cooperation Programme



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ish ndërtesa e Rilindjes, kati i 12-të, Prishtinë, Kosovë

Adresa postare:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Adresa e postës elektronike: Hzbije.Kelmendi@rks-qov.net

Subjekti: "Aplikacioni për zyrtar i projektit i specializuar në komunikim dhe informim për Programin BNK Shqipëri - Kosovë".

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen për intervistë.

Shënim: Vetëm aplikacionet e pranuar para përfundimit të afatit të përcaktuar në konkurs do të merren në konsideratë për shqyrtim.

PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS

Pozita: Zyrtar i projektit i specializuar në komunikim dhe informim në Sekretariatit e Përbashkët Teknik (SPT) - Zyra e Antenës së Programit të IPA-s për Bashkëpunim Ndërkufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës (2014-2020)

Lokacioni: SPT - Zyra e Antenës në Prizren, Kosovë

Përshkrim i përgjithshëm

Zyrtari i projektit, i specializuar në komunikim dhe informim do të vendoset në zyrën e Antenës në Prizren, mirëpo nga ai/ajo pritet që të punojë edhe në terren në të dyja vendet e përfituesve në mënyrë të barabartë. Kjo pozitë parasheh një maksimum prej 570 ditëve të punës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Të paktën **75%** të këtyre ditëve të punës duhet të shpenzohen në territorin e paraparë.

Nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të ekipit, përkatësisht udhëheqësit të Sekretariatit të Përbashkët Teknik, zyrtari i projektit do të jetë përgjegjës për të gjitha çështjet që ndërlidhen me menaxhimin dhe zbatimin e programit, duke përfshirë bashkërendimin e aktiviteteve të veçanta. Ai/ajo do të luajë rol themelor në raportimin e kontratës, menaxhimin e burimeve, ofrimin e ndihmës në shpalljen e thirrjeve për projekt-propozime, monitorimin në terren të projektit (rezultatet në veçanti), mbledhjen e të dhënave për



This project is funded by the
European Union



Albania – Kosovo

IPA Cross Border Cooperation Programme



përpilimin e raporteve mbi programin, dhe mbi të gjitha mbështetjen e aktiviteteve që ndërlidhen me publicitetin, ekspozimin dhe informimin.

Zyrtari i projektit i specializuar në komunikim dhe informim do të kryej detyrat e mëposhtme:

- Merr të gjitha masat e duhura në bashkëpunim të plotë me strukturat operative si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në udhëzuesin praktik dhe procedurat e tjera përkatëse për të siguruar që thirrja për propozime e publikuar në nivel shtetëror dhe rajonal t'i arrijë grupet e synuara;
- Mbledh dhe sistemon raporte të ndryshme teknike të përfituesve;
- Ofron ndihmë administrative dhe logjistike për Autoritetin Kontraktues, strukturat operative dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit;
- Ofron mbështetje në zbatimin e projekteve të financuara përmes ofrimit të trajnimeve dhe këshillave për aplikantët dhe përfituesit potencial në lidhje me përfundimin e suksesshëm të projekteve, si p.sh. manuale, udhëzime dhe këshilla në lidhje me zbatimin dhe raportimin, etj.;
- Bashkëpunon me organizata, institucione dhe rrjete të rëndësishme për arritjen e objektivave të programeve;
- Monitoron zbatimin e punëve (pjesëmarrja në vizita monitoruese, përgatitja e raporteve të monitorimit);
- Siguron futjen e të gjitha informatave të nevojshme të programit dhe projektit në Sistemin e Monitorimit të Programit; përditëson në mënyrë të rregullt bazën e të dhënave me informatat më të fundit;
- Përgatit raporte, statistika dhe informata në lidhje me progresin e projektit dhe zbatimin e programit sipas kërkesës së akterëve për menaxhim të programit;
- Kryen detyra tjera në lidhje me zbatimin e programit sipas kërkesës së udhëheqësit të SPT-së;
- Merret me punët e informimit dhe komunikimit;
- Kryen detyra tjera të caktuara nga udhëheqësi i SPT-së.



This project is funded by the
European Union